



RAPORT MONITORIMI NE KUADER TE PROJEKTIT `KONCESCAN

PERGATITUR NGA OPEN DOORS

TIRANE, 2018

PJESA III



KAPITULLI VI

6.0 PJESA STUDIMORE

6.1 QËLLIMI I STUDIMIT

Ky studim synon matjen e perceptimit qytetar ndaj shërbimeve publike të ofruara nga zbatimi i kontratave koncesionare / PPP nga pushteti vendor në Fier dhe Divjakë si edhe advokimin në përkrahje të interesave të komunitetit lokal të afektuar.

Objekt i propozimit janë 2 kontrata koncesionare / PPP të cilat janë në faza të ndryshme të zbatimit të tyre, me autoritet kontraktues secilën prej Bashkive përkatëse:

- Ndërtimi dhe Administrimi i impiantit të Trajtimit të Mbetjeve Urbane në Fier (2016)
- Dhënia me koncensione e 338 kabinave plazhi të Divjakës qeramarrësve të ndryshëm, duke pretenduar në mirëmbajtjen e tyre sipas standardeve të kërkuara nga turistët dhe turizmit (2010)

Në këtë kapitull fokusi do të jetë mbledhja e të dhënave dhe analiza e rezultateve mbi elementët e informimit dhe konsultimit paraprak me komunitetin në lidhje me dobishmërinë dhe efektivitetin e këtyre shërbimeve si edhe paraqitja e analizës së plotë kosto/përfitime për të parë se sa përkthehen këto partneritete në dobi të komunitetit. Gjithashtu, në këtë fazë do të analizohet se deri në çfarë mase është marrë në konsideratë zëri i qytetarëve në implementimin e projekteve të tilla afatgjata si edhe impakti i tyre ligjor, mjedisor dhe social- ekonomik tek komunitetet e prekura.

Pyetjet Kërkimore

Për realizimin e qëllimit të këtij studimi janë hulumtur tre fusha të ndryshme interesi që prekin sferën e realizimit dhe vënies në praktikë të kontratave koncesionare/ PPP, në rastin konkret nga pushteti vendor i Fierit dhe Divjakës. Më konkretisht këto përfshijnë:

1. Nivelin e ndërgjegjësimit të përgjithshëm të komunitetit mbi natyrën e kontratave koncesionare dhe specifikat e tyre
2. Përceptimit mbi nivelin e transparencës për komunitetin lidhur me pozicionimin dhe rolin e luajtur nga pushteti vendor në raport me kontratat koncesionare të Fierit dhe Divjakës.
3. Perceptimin mbi impaktin ligjor, mjedisor, social dhe ekonomik që këto kontrata dhe rezultatet e tyre do të kenë mbi komunitetin

Secila nga këto tre aspekteve të përgjithshme u analizua nisur nga dimensionet specifike përbërëse. Tërësia e përgjigjeve individuale mbi këto dimensione së bashku me analizat në thellësi të aspekteve më të rëndësishme të nxjerra gjatë hulumtimit, përbëjnë elementet kryesore të këtij kapitulli.

Metodologjia e Përdorur

Studimi është realizuar si një gërshetim metodash sasiore dhe cilësore në mbledhjen dhe analizën e të dhënave. Për hulumtimit të përgjithshëm mbi nivelin e ndërgjegjësimit, perceptimin e transparencën dhe mbi impaktin ligjor, mjedisor, social dhe ekonomik u përdor metodologjia e sondazhit me anketim dhe të dhënat u analizuar me programin statistikor SPSS version 23. Të dhënat dhe analizat sasiore u pasuruan më tej me informacion më të detajuar cilësor i cili u vu në dispozicion gjatë zhvillimit të dy fokus grupeve të veçantë në Fier dhe Divjakë. Dy Fokus grupet përbëheshin përkatësisht nga 10 pjesëmarrës për Fierin dhe 6 pjesëmarrës për Divjakën dhe rezultatet e tyre u analizuan me metodën e analizës së përmbajtjes.

Analizat e të dhënave sasiore dhe cilësore do të paraqiten në dy seksione të veçanta ku, nëse nga njëra anë rezultatet e përgjithshme të sondazhit do të konsiderohen në mënyrë të pa diferencuar për Fierin dhe Divjakën, analizat cilësore të dy fokus grupeve, përgjegjëse për një informacion më të detajuar, do të merren të ndara për Bashkinë e Fierit dhe të Divjakës.

Kampioni

Në total janë intervistuar 150 subjekte nga të dyja bashkitë e Fierit dhe të Divjakës. Kampioni i përzgjedhur ishte jo i rastësishëm ose kovenient. Nisur nga nevojat e studimit u përzgjedhën subjekte të zonave të prekura nga kontrata koncesionare. Kampioni kishte përfaqësi nga të dyja gjinitë, shpërndarje të mirë sipas grupmoshave si edhe subjekte nga të gjitha shtresat e popullsisë. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve ishin të punësuar në sektorin publik dhe privat

duke u ndjekur nga përfaqëues të sipërmarrësve/biznesit. Gjithashtu në sondazh u përfshinë subjekte të pa punë, përfaqësues nga shoqëria civile, këshilli bashkiak, media, sikurse edhe studentë, pensionistë dhe të punësuarit në sektorin bujqësor dhe blektoral.

Në Fokus groupe pjesëmarrësit u përzgjedhën duke respektuar kriteret e një kampionimi të qëllimshëm me synimin që të kishim përfaqësues nga të gjitha shtresat e interesuara (Bashkitë dhe këshilli bashkiak, individë nga komuniteti, sipërmarrës të zonës, media dhe shoqëria civile)

Sondazhi me pyetësorë

Në Shtojcën 1 gjendet i bashkëngjitur standardi i pyetësorit të përdorur gjatë realizimit të sondazhit.

Analizat i referohen kryesisht të dhënave demografike mbi subjektet pjesëmarrëse (gjinia, vendbanimi/vendlindja, grupmoshat e pjesëmarrësve, niveli i edukimit, punësimi, të ardhurat), të dhënat mbi nivelin e informimit në lidhje me kontratat koncesionare dhe të angazhimit në këtë proces të aktorëve kryesor që veprojnë në komunitet (media, shoqëria civile, individ aktiv të komunitetit, biznesi), të dhënat mbi transparencën e perceptuar nga pushteti vendor dhe përdorimin e instancave kryesore që ndikojnë në informimin dhe pjesëmarrjen e komunitetit (dëgjuesat publike, interneti dhe portalet online, media e shkruar dhe vizive, informimi jo-formal (gojarisht)), të dhëna mbi perceptimin e respektimit të ligjeve në fuqi dhe të abuzimeve të mundshme ligjore lidhur me këto kontrata, të dhëna mbi perceptimin e impaktit mjedisor (ajër, ujë, territor) dhe pasojat mbi secilën prej specifikave konkrete, të dhëna mbi impaktin e kontratave koncesionare në zhvillimin shoqëror të komuniteti dhe në stresin ambiental, të dhëna mbi perceptimet në zhvillimin e bizneseve, punësimit dhe të ardhurave të pushtetit vendor në funksion të komunitetit vendas.

Fokus grupet

Dy Fokus grupet përbëheshin përkatësisht nga 10 pjesëmarrës për Fierin dhe 6 pjesëmarrës për Divjakën dhe rezultatet e tyre u analizuan me metodën e analizës së përmbajtjes.

6.2 ANALIZA E TË DHËNAVE

Të dhënat socio-demografike

Në anketimin me sondazh të realizuar gjatë studimit mbi matjen e perceptimit qytetar ndaj shërbimeve publike të ofruara nga zbatimi i kontratave koncesionare / PPP nga pushteti vendor në Fier dhe Divjakë, 55% e pjesëmarrësve ishin femra dhe 45% meshkuj nga 148 subjekte që ju përgjigjën kësaj pyetjeje (dy të dhëna mungojnë nga 150 subjekte që kanë marrë pjesë në sondazh)




Figura 35. Grafiku i pjesëmarrësve sipas gjinisë

Nga të dhënat e tabelës vihet re se më shumë se gjysma e pjesëmarrësve të studimit janë përzgjedhur nga Bashkia e Fierit. Kjo përzgjedhje është bërë me qëllim dhe në funksion të studimit pasi, duke qenë se Fieri është një Bashki me një popullsi më të madhe se ajo e Divjakës, duhej të kishte një përfaqësim më të madh në kampionin studimor. Nga tabela vëmë re gjithashtu se subjektet me vendlindje në Fier nuk ndryshojnë shumë nga ata që aktualisht janë me vendbanim në këtë Bashki. Situata paraqitet pak më ndryshe për Divjakën pasi, sikurse evidentohet në tabelë, pjesëmarrësit me vendbanim Divjakë janë gati dy herë më shumë me ata që kanë vendlindjen duke evidentuar kështu se pjesa tjetër janë flukse banorësh të ardhur më vonë në këtë Bashki.

Tabela. 19 Vendlindja dhe vendbanimi i pjesëmarrësve

| Të Dhëna Demografike | Vendlindja | % | % e vlefshme | Vendbanimi | % | % e vlefshme |
|----------------------|------------|------------|--------------|------------|------------|--------------|
| Fier | 78 | 52.0 | 55.3 | 74 | 49.3 | 53.2 |
| Divjake | 37 | 24.6 | 26.3 | 61 | 40.7 | 43.9 |
| Tjetër | 26 | 17.3 | 18.4 | 4 | 2.7 | 2.9 |
| Pa përgjigje | 9 | 6.1 | - | 11 | 7.3 | - |
| Total | 150 | 100 | 100 | 150 | 100 | 100 |

Grafiku tortë i mëposhtëm tregon shpërndarjen e pjesëmarrësve në sondazh sipas grup-profesionit të tyre. Sikurse vihet re pjesa më e madhe e pjesëmarrësve janë punësuar në sektorin privat duke u ndjekur nga ai publik kurse vetëm 13 subjekte janë përfaqësues të sipërmarrësve ose të biznesit. Grafiku tortë evidenton faktin që në sondazh kanë marrë pjesë gjithashtu edhe subjekte të pa punë (një pjesë e konsiderueshme 13 të tillë) përfaqësues nga shoqëria civile, këshilli bashkiak, media si edhe në fund një kategori individësh prej 37 subjektësh të përbërë nga studentët, pensionistët dhe të punësuarit në sektorë të tjerë.




Figura. 36 Grafiku i shpërndarjes së pjesëmarrësve sipa profesioni

Në histogramën e më poshtme vihet re se pjesa më dërmuese e popullsisë jetojnë me të ardhura shumë të ulta (59 pjesëmarrës marrin më pak se 30.000 lek në muaj) dhe po thuajse i njëjti numër pjesëmarrësish jetojnë me të ardhura mesatare (57 pjesëmarrës marrin 30.000-59.000 lek

në muaj). Kjo pjesë e subjekteve përbën rreth 81% e të gjithë të intervistuarve duke bërë që vetëm 15 % e subjekteve pjesëmarrëse të mund të klasifikohen me të ardhura të bëmira dhe/ose të larta (21 subjekte marrin 60.000- 99.000 lek në muaj) dhe, akoma dhe më pak, si të pasur dhe/ose shumë të pasur (7 subjekte marrin 100.000- mbi 150.000 lek në muaj).




Figura. 37 Grafiku i shpërndarjes së të ardhurave të pjesëmarrësve

Dy tabelat e mëposhtme paraqesin përkatësisht grupmoshat dhe nivelin e edukimit për pjesëmarrësit nga të dyja bashkitë e përfshira në studim. Siç vihet re në tabelën. 20, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve janë të grupmoshës 26-35 vjeç për t'u ndjekur më pas nga grupmoshat 19-35 dhe 36-45 vjeç. Gjithashtu edhe grupmosha 46-55 vjeç ka një përfaqësi prej 24 subjektsh pjesëmarrëse në sondazh.

Tabela. 20 të dhënat mbi frekuencën dhe përqindjen e vlefshme të grupmoshës së pjesëmarrësve

| Grupmoshat | Frekuenca | % e vlefshme |
|---------------|-----------|--------------|
| 18 | 11 | 7.4 |
| 19-25 | 28 | 18.9 |
| 26-35 | 34 | 23.1 |
| 36-45 | 27 | 18.2 |
| 46-55 | 24 | 16.2 |
| 56-65 | 16 | 10.8 |
| mbi 65 | 8 | 5.4 |
| Total | 148 | 100.0 |

Sikurse vihet re nga tabela. 21 pjesa më dërmuese e pjesëmarrësve janë subjekte me një nivel të mesëm formimi, 66 pjesëmarrës ose 45.2 % e tyre. Kjo vlerë pasohet nga subjektet pjesëmarrëse me nivel formimi universitar 50 subjekte dhe më pak janë përfaqësuesit me nivel formimi post-universitar (19 subjekte) dhe nivel i ulët (vetëm 11 subjekte pjesëmarrëse)

Tabela. 21 Të dhënat mbi frekuencën dhe përqindjen e vlefshme të edukimit të pjesëmarrësve në studim

| Niveli i Edukimit | Frekuenca | % e vlefshme |
|-------------------------------|------------------|---------------------|
| Nivel i ulët | 11 | 7.5 |
| nivel i mesëm | 66 | 45.2 |
| Nivel universitar | 50 | 34.3 |
| Nivel post-universitar | 19 | 13.0 |
| Total | 146 | 100.0 |

Ndërgjegjësimi dhe niveli i informimit mbi dy kontratat

Nga të dhënat e sondazhit, rreth 86 subjekteve ose 62% e të interesuarve e konsiderojnë veten mjaftueshëm dhe shumë të interesuar mbi çështjet që prekin komunitetin. Pavarësisht këtij fakti, shumtë janë nuk kanë aspak ose kanë vetëm pak informacion mbi kontratën koncesionare aktuale (76 subjekte ose 55% e tyre) dhe për më tepër, kjo tencendë mosinformimi i referohet kryesisht përcjelljes së informacionit që para nënshkrimit të kontratës (101 subjekte ose 79% e tyre) si edhe mungesës së informacionit për ndryshimeve të mundëshme në lidhje me këto kontrata (105 subjekte ose 75% e tyre).

Subjektet shfaqen gjithashtu pak të bindur në lidhje me rolin e strukturave të tilla si media, shoqëria civile, individ aktiv të komunitetit dhe sipërmarrës, të cilat priten të kenë ndikim në politikat e ndërmarra nga pushteti qendror dhe ai vendor mbi çështje që lidhen dhe që prekin komunitetin. Tek individët ka një bindje të konsiderueshme që këto struktura janë aspak ose vetëm pak aktive për të patur ndikim në vendimarrjen e pushtetit qendror dhe vendor në lidhje me kontratat koncesionare

Tabela. 22 Të dhënat mbi perceptimin qytetar në nivelin e ndikimit në politikat e pushtetit qëndror/vendor

| Ndikimi në politikat e pushtetit qëndror/vendor | Media | Shoqeria Civile | Individë të Komunitetit | Sipërmarrës |
|--|--------------|------------------------|--------------------------------|--------------------|
| Aspak | 40 | 30 | 53 | 45 |
| Pak | 35 | 54 | 30 | 44 |
| Disi | 38 | 28 | 27 | 24 |
| Mjaftueshem | 23 | 26 | 25 | 21 |
| Shume | 12 | 12 | 15 | 16 |
| Pa Përgjigje | 2 | – | – | – |

Perceptimi i transparencës ndaj pushtetit vendor

Mbi 55 % e subjekteve (83 subjekte) pjesëmarrës e konsiderojnë bashkinë aspak ose pak transparente në lidhje informacionet që ka dhënë mbi kontratat koncesionare. Kjo vlerë është në raport me 26% të subjekteve (40 subjektet) që e konsidrojnë mjaftueshëm dhe shumë transparent informimin e dhënë nga bashkia mbi këto kontrata koncesionare.

Nga analiza e të dhënave rezulton gjithashtu se subjektet e perceptojnë transparencën e Bashkisë të lidhur me përcjelljen e informacionit nëpërmjet medias, dëgjesave publike dhe faqes së internetit/FB-së Bashkisë. Nga të dhënat rezulton se ky model shpjegon 33% të perceptimit të transparenës për komunitetin. Peshën kryesore në këtë model perceptimi të transparencës e luan a) organizimi i dëgjesave publike ($t = 4.044$, sign. 0.000), b) përcjella e informacioneve nëpërmjet medias dhe gazetës ($t = 2.699$, sign. 0.008) dhe c) përcjellja e informacionit mbi kontratat nëpërmjet Fb dhe Site-it zyrtar ($t = 1.84$, sign. 0.067). Përtej këtij modeli të dhënat tregojnë se perceptimi pulik mbi rolin e dëgjesave publike, medias dhe faqes zyrtare/FB së Bashkisë është i ulët.

Subjektet rezultojnë se janë aspak ose pak të kënaqur me dëgjesat publike (59% ose 89 subjekte), kanë marrë aspak ose pak informacion nga TV, gazeta, etj (60% ose 90 subjekte), aspak ose pak informacion të përcjellë gojarisht (67% ose 100 subjekte) dhe janë aspak ose pak të informuar mbi anët positive dhe negative të kontratës (57% ose 85 subjekte).

Rreth 74 % e të intervistuarve (111 subjekte) gjithashtu kanë deklaruar se janë aspak ose pak të informuar mbi kontratat koncesionare nga site-i zyrtar apo faqja e facebook-ut të bashkisë. Nisur nga fakti se të dhënat demografike demostrojnë që 68% e pjesëmarrësve (100 subjekte) janë të një moshe të re (nga 18-45 vjeç), presupozojmë që kjo grupmoshë nuk shfaq problem të konsultimit me internet të faqes zyrtare apo të FB-së së Bashkisë.

Hulumtim i impaktit ligjor, mjedisor, social dhe ekonomik

Impakti ligjor

Nga të dhënat e sondazhit rezulton se më shumë se gjysma e pjesëmarrësve janë aspak, pak dhe disi të kënaqur me qëndrimin e Bashkisë në lidhje me kontratën koncesionare. Në rastin e Bashkisë Fier për shembull, në lidhje me pyetjen mbi përdorimin e tokës ku do të ndërtohet impianti, qëndrimi i Bashkisë nga pjesëmarrësit konsiderohet në disa raste si imponues, ose si i fshehtë/ i paqartë/ jo transparent ose i paqëndrueshëm dhe në disa raste të tjera i kotë ``si figure`` ose deri i frikësuar.

Rreth 58 % e subjekteve (87 subjekte) mendojnë se ligji në fuqi mbi koncensionet është respektuar aspak ose pak. Kjo shihet më së shumeti e lidhur me format e abuzimit nga pushtetarët dhe përfaqësuesit politik ($r = -0.555$, $p = 0.01$) sesa me abuzimet e drejtëpërdrejta mbi ligjin për kontratat koncensionare, pavarësisht faktit se, edhe këtu, perceptimi i lidhjes është i fortë ($r = -0.449$, $p = 0.01$). Këto të dhëna vënë në dukje frikën sinjifikative që pjesëmarrësit kanë në lidhje me abuzimet ligjore mbi kontratën koncesionare. Kjo frikë rezulton si pasojë e një ndërveprimit shumë të fortë që vihet re midis abuzimeve ligjore dhe abuzime nga pushtetarë dhe përfaqësues politik ($r = 0.693$, $p = 0.01$). Këto të dhëna tregojnë pikë së pari që përgjigja nuk është rastësore dhe, së dyti, që në perceptimin publik respektimi i ligjit lidhet shumë me korrektesën e pushtetarit, i cili është parësori për abuzime të mundëshme ndaj ligjit. Mbi bazën e këtyre të dhënave mund të ngremë përfundimin se perceptimi i qytetarëve është se abuzimet vijnë paraprakisht nga pushtetarët të cilët e realizojnë këtë nëpërmjet abuzimeve të drejtëpërdrejta me ligjin.

Impakti social

Përgjithësisht subjektet kanë një perceptim pesimist lidhur me ndikimet positive të kontratës në zhvillimin e zonës. Rreth 75% e subjekteve mendojnë se kontrata do të ketë aspak, pak edhe

vetëm disi impakt pozitiv në zhvillimin e zones. Kjo do të thotë që vetëm 25% e subjekteve janë optimist në zhvillimet positive që do të ketë zona. Ky aspekt është shumë i lidhur me dimensionin ekonomik sipas së cilit, 94 subjekte ose 68% e totalit të tyre, gjithashtu mendojnë se kontrata do të sjellë aspak, pak edhe disi të ardhura ekonomike për zhvillimin e ekonomisë lokale (regresion linear sipas së cilit $R^2 = 0.43$ do të thotë se të ardhurat ekonomike vlerësohen nga subjektet dhe shpjegojnë 43% të impaktit pozitiv të kontratës në zhvillimin e zones, $t = 10.145$, $p = 0.000$).

Sikurse është theksuar edhe më sipër në lidhje me ndikimin e strukturave të tjera (media, shoqëria civile, individ aktiv të komunitetit dhe sipërmarrës) ndaj politikave të ndjekura, 99 subjekte ose 66% e totalit të pjesëmarrësve gjykojnë se banorët e zonës kanë qenë vetëm pak, aspak ose disi aktiv në mbrojtje të interesave të tyre. Në këtë kuadër, vihet re një lidhje domethënëse midis aktivizimit të banorëve në mbrojtje të interesave të tyre dhe perceptimin e reagimit të medias (0.467 , $p = 0.01$) dhe aktivizimit të shoqërisë civile (0.481 , $p = 0.01$). Sikurse evidentojnë të dhënat, aktivizimi i komunitetit rezulton i ndikuar kryesisht nga media dhe shoqëria civile.

Impakti mjedisor

Përsa i takon tre ndër aspekteve kryesore që prekin tematikën e kujdesit për mjedisin, siç është respektimi i kriterëve për grumbullimin e mbetjeve, mosndotja e burimeve ujore dhe mirëmbajtjen e higjenës, pjesa më e madhe e subjekteve rezultojnë pesimist, pavarësisht faktit se kjo diferencë në vlera nuk rezulton të jetë domethënëse. Mund të konkludohet se, lidhur me këto aspekte, perceptimet e subjekteve janë sa positive aq dhe negative sikurse ka edhe një pjesë të mirë të subjeteve që abstetojnë të marrin një pozicion të saktë pasi ndoshta nuk konsiderohen të mirëinformuar.




Figura. 38 Grafiku mbi të dhënat e perceptimin të impaktit mjedisor

Nga të dhënat e studimit subjektet më së shumeti rezultojnë të shqetësuar mbi ndotjen e përgjithshme të mjedisit (66 subjekte janë përgjigjur mjaftueshëm/shumë) pavarësisht se një pjesë tjetër e konsiderueshme e tyre (52 subjekte) mendojnë se nuk do të ketë aspak ose pak ndotje mjedisore si pasojë e zbatimit të kontratës koncesionare.

Mbetet për t`u analizuar se cilët janë faktorët kryesor që ndikojnë në një perceptim të tillë.




Figura. 39 Grafiku i perceptimit të dëmtimit të mjedisit nga zbatimi i kontratës

Një grup të dhënash që mund të na përcjell informacion të mëtejshëm janë ato ndërveprime sipas së cilave, perceptimi i ndotjes së mjedisit rezulton i lidhur si me kriteret për mosndotjen e burimeve ujore dhe nëntokësore ($r=-0.308$, $p=0.01$), ashtu edhe me kriteret për mirëmbajtjen e higjenës së zonës përreth ($r= -0.285$, $p=0.01$). Në çdo rast, marrëdhënien më domethënëse ky aspektet e shfaq me kriteret për mosndotjen e ajërit në zonën e zbatimit të kontratës ($r= 0.861$, $p=0.01$). Kjo tregon se tek subjektet perceptimi mbi ndotjen mjedisore është i lidhur kryesisht me ndotjen e ajërit. Pavarësisht kësaj, subjektet shfaqen të ndarë midis atyre që mendojnë se do të ketë aspak/pak ndotje të ajërit në zonën e zbatimit të kontratës (58 subjekte) dhe atyre që, në të kundërt, mendojnë se do të ketë mjaftueshëm/shumë ndotje në këto zona specifike (54 subjekte). Lidhur me shqetësimet mbi çështjen e vibrimeve dhe të zhurmave si edhe ato të lidhura me rëndimin e trafikut nga automjetet e rënda, një numër i konsiderueshëm subjektësh mendojnë se ato do të ndikojnë aspak ose pak. Këto vlera janë përkatësisht 48 subjekte për zhurmat dhe 56 subjekte për rëndimin e trafikut . Thënë ndryshe, vetëm 32% e subjekteve në rastin e parë dhe 37% e subjekteve në rastin e dytë janë mjaftueshëm dhe shumë të shqetësuar për këto aspekte. Mbetet me interes për studimin tonë të kuptojmë dinamikat e lidhura me informimin dhe aspekte të tjera që çojnë drejt këtyre rezultateve.

Impakti ekonomik

Nga të dhënat studimore rezulton se më shumë se gjysma e subjekteve nuk mendojnë se do të ketë ndryshime thelbësore në rritjen e punësimit dhe kualifikimit të banorëve nëpërmjet kontratës koncesionare (76 subjekte për 149 të pyetur në total).




Figura. 40 Grafiku shembull mbi perceptimin qytetar në rritjen e punësimit dhe kualifikimit të banorëve nga kontrata koncesionare

Edhe pse pjesa më dërmuese e subjekteve kanë aspak/pak dhe disi informacion mbi të ardhurat që do të gjenerojë bashkia, kjo nuk kushtëzon pjesën më të madhe të tyre (102 subjekte ose 68%), të mendojnë se kontrata do të sjellë aspak/pak dhe disi të ardhura për ekonominë lokale.




Figura. 41 Grafiku i marrëdhënies midis informimit qytetar dhe perceptimit mbi përfitimin ekonomik nga kontrata koncesionare

Duke ritheksuar edhe një herë faktin që ky është vetëm qëndrimi dhe opinion i subjekteve të përfshirë në sondazh, pasi, sikurse u tha, subjektet nuk janë të informuar mbi të ardhurat specifike që do të gjenerojë bashkia (106 ose 71% e subjekteve deklarojë se janë aspak dhe pak

të informuar si edhe 127 ose 85% e subjekteve deklarojnë se janë aspak, pak edhe disi të informuar mbi të ardhurat që do të gjenerojë bashkia) lind pyetja se, në kushtet e mungesës së informimit, çfarë i ndikon qëndrimet e pjesëmarrësve mbi të ardhurat në ekonominë lokale? Sa ndikon mungesa e informimit nga Bashkia në tendencat e qëndrimeve të pjesëmarrësve?

Analiza me të dhënave me fokus grup

Bashkia Fier

Çështjet kryesore që i referohen veçantisë së kontratës koncesionare në rastin e Bashkisë së Fierit e lidhur me ndërtimin dhe administrimin e impiantit të Trajtimit të Mbetjeve Urbane, fokusohen rreth këtyre problematikave kryesore: situata e informimit të qytetarëve, prezantim nga specialistët mjedisor dhe ekspertë të tjerë mbi avantazhet dhe disavantazhet e kesaj kontrate kryesisht në impaktin mjedisor të saj, përfshirja dhe roli i mediave të ndryshme në këtë proces, përfitimet e mundshme ekonomike nga kontrata për bashkinë dhe komunitetin. Të gjitha këto tema u parashtruan gjatë diskutimeve në fokus grup ku pjesëmarrës të ndryshëm hodhën këndvështrimet e tyre më në detaje dhe thellësi mbi ndikimin pozitiv dhe negativ të secilës në nivelin e informimit dhe perceptimin e pjesëmarrësve nga komuniteti mbi këtë kontratë koncesionare. Disa përfundime të analizës së rezultateve të këtij fokus grupi janë parashtruar si më poshtë:

Një faktor që rezulton si vendimtar në formimin e perceptimit dhe opinionit publik mbi këtë kontratë koncesionare dhe që ndez diskutime të gjera midis palëve, është **përfshirja dhe angazhimi i komunitetit në dëgjesa publike**. Një argument i tillë shfaqet si thelbësor dhe përsëritet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë fokus grupit, duke evituar ato aspekte që konsiderohen si vendimtare në përcaktimin e karakteristikave që duhet të ketë organizimi i këtyre degjesave me qëllim që të jetë eficient, funksional dhe që të risë nivelin e kënaqësisë së komunitetit. Në këtë kuadër, bëhet e rëndësishme që dëgjesat të karakterizohen nga këto aspekte kryesore

✓ Duhet të jenë sa më **të hapura**:

Zhvillimi i dëgjesave publike duhet të jetë një prioritet i Bashkisë dhe njësive administrative duke u konsideruar si i vetmi kontekst ku komuniteti jo vetëm të informohet por edhe të jetë aktiv në vendimarrje. Kjo kërkon një informim të vazhdueshëm në kohë dhe sa më të hapur ku

komuniteti të jetë aktor aktiv në diskutimet në funksion të tij. Ky gjykohet si një mekanizëm që rrit kredibilitetin dhe besueshmërinë në vendimarrjet e Bashkisë dhe të njësive administrative.

...ka mbledhje të Keshill Bashkiak që behen në fshehtësi pa lajmeruar...kam prova...ne parim flasim të gjithë mirë, bashkia mbron pozicionin e vetë, politika të vetin dhe populli të vetin....

...ne e kemi marrë seriozisht degjencën publike dhe mbledhja jo rastesisht u la në orën 5 pasi njerezit të vinin nga puna e të ishin sa më shumë në degjencë....takimi u afishua fillimisht në Bashki e më pas u njoftua në FB-në e Bashkisë dhe në rrjetet sociale por edhe në njësitet administrative edhe pse ju thonë që nuk ka patur njoftim....

...sot që flasim nuk ka plan për ndertimin e impiantit pa pelqimin e qytetarëve por nëse do të ketë një studim landfilli atëherë do ta shohim me detaje por nuk do të lemë qytetaret në asnjë moment jashtë diskutimit... gjithçka është në diskutime dhe i qëndrojmë asaj që ka thënë kryetari i Bashkisë se pa miratimin e qytetarëve nuk do të ketë asnjë ndertim të impiantit në asnjë zonë në Fier...

e themë me përgjegjësi se Keshill Bashki ka bërë të gjitha takimet e tij të hapura e me transparencë të plotë për të gjashtë zonat ku është diskutuar ndërtimi i landfillit...

...mendoj se banoret e Portez do të shkojnë vërtetë në Elbasan për të parë sa modern është landfilli...do ishte e mira që juve si Keshill bashkiak të ishit pak më të mirë e seriozë në çështjen e informimit të njerezve...ne informohemi gjithnjë pasi gjeja bëhet realitet pasi ato ndodhin..do ishte në të mirën e të gjithë qytetarëve të të gjitha zonave që të ishin të informuar seriozisht dhe me përgjegjësi nga ana juaj..duhet të dini se qytetari i Fierit i është larguar sot Bashkisë, nuk ka besim tek ajo...po të kishte interes takimet nuk do të ishin bërë formale...shikoji takimet që behen në Bashki vetëm me njerez të përcaktuar, të informuar e të njoftuar sic doni ju....

✓ Duhet të jenë **periodike** dhe të interesuarit të **njoftohen paraprakisht**

Lind nevoja që organizimi i dëgjësive publike të jetë i herë pas herëshëm dhe jo përqëndruar në vetëm disa takime sporadike në kohë. Këto dëgjesa publike duhen njoftuar në kohën e

përshtatshme me qëllim që të gjithë anëtarët e interesuar të komunitetit të gjejnë hapsira për të qene prezent në to.

-...jemi mbledhur tre here dhe njerezit kane ardhur vete dhe në mbledhjet e keshillit ka patur shume prezence. Këto mbledhje kane qene te hapura edhe vete kryetari bashkise ka qene ne keto takime...ndaj informacioni ka qene i mjaftueshem dhe peridik...

-....nuk eshte e vertete jane qytetaret qe te manipuluar i kane bere bllok informacioneve...

- Jo nuk eshte keshtu, juve keni dhene informacione siç keni dashur dhe nuk jepet informacioni vetem me dy takime qe keni bere...duhet te ishin bere nje seri takimesh dhe me sa me shume njerez e jo me njerez qe i caktoni ju te vijne....

✓ **Informacioni në to duhet të jetë i plotë dhe jo kontradiktor**

Komunitetit i nevojitet që informacioni ti përcillet sa më i plotë, me aspektet positive dhe negative të tij, duke bërë të mundur në këtë formë eliminimin e pikëpyetjeve mbi aspekte të pa qarta apo sjelljet që vijnë si rezultat i informacioneve që vijën nga burime të tjera, të ndryshme nga pushteti vendor dhe që çojnë shpesh në sjellje kontradiktore. Informacioni i pasur në të gjitha aspektet, koherent dhe i njëtrajtshëm do të ndikoj pozitiv në përhapjen e frytshme të tij në komunitet duke ulur ndjeshëm mundësinë e sjelljeve dhe organizimeve të paligjshme dhe deviante.

-...une mendoj se nese do te ishte punuar me seriozitet e transparence nga Bashkia do te ishim ne nje suate tjeter tani..shiko, nje informacion serioz perhapet me kollaj, une kur jam i bindur vete do kembengul qe kete ta perhap tek komshia ime, tek shoku ne kafe, ne lagje e fshat duke e bindur edhe ate per te mrat e investimit pasi jam vete i bindur,....por duke qene se kam nje informacion te percipete atehere jam i prirur me shume drejt dyshimit....

-...kalimi i landfillit nga Porteza ne gjashtë vende te tjera u be kaq shpejt e shpejt...por si qënka kaq e lehtë nje gje e tille, si u spostua keshtu fet e fet?! Pse u spostua ne Brostar pa u marre vendimi i specialisteve..por u be se donte ky apo ai?!

-...banoret e Pertez kishin zero informacion dhe transparence... ata qe protestuan ishin ata qe mendonin se landfilli do te ngrihej afër shtepive te tyre...dhe e pse e bene kete, sepse nuk kishin asnje informacion te sakte, madje kishin nje mori informacionesh nga me te ndryshmet dhe kontradiktore

-Kishte edhe elemente politike brenda protestes dhe mendoj se mungesa e vazhduesheme e informacionit ose nje informacion i pjesesesh ose kontradiktorka qene arsyeja se perse manipuloheshin banoret vazhdimisht...

✓ Nuk duhet të kenë **ngjyrime politike** apo të përdoren politikisht

Përdorimi politik i çështje me karakter social që kanë në qendër përmirësimin e cilësisë së jetës dhe zhvillim ekonomik të zonave lokale, është ndër aspekt që mund të ndikojë më negativsh në perceptimin e transparencës dhe besueshmërinë nga drejtuesve në komunitet. Shqetësimet mbi manipulimet me përfitime politike rezultojnë si aspektet më flagrante të trajtura dëndurazi nga pjesëmarrësit në fokus grupin e Fierit

...duhet hedhur hapi i pare me banoret dhe jo te marresh 30 simpatizante e mbeshtetes te tu dhe te besh, mbledhje dhe ti sheses ata sikur te mbeshtesin apo te kundershtojne...ky landfill duhet te jete transparent per njerezit e zonave e jo per mbledhje te mbyllura me simpatizante partish....pse po perdoren ata politikisht dhe perse nuk ka asnje informacion shtrerrues per te..perse asnje anetar i keshill bash nuk po e ngre zerin pasi jane te politizuar?!..hapi i pare qe duhet bere eshte qe komuniteti te vihet ne dijeni me detaje e me pas hapat e tjere..dhe ju nuk duhet te perdorni forcen apo shtrengimin..

Njesia administrative Mbrostar vendosi ti njoftoje qytaret per takimin me kryetarin e bashkise por qytetaret e manipuluar politikisht e sabotuan ate..degjesat jane bere por ne te shumten e rasteve banoret kane qene te manipuluar politikisht se sa kane dashur te jene te informuar...eshte bere nje loje e madhe nga forcat politike...

-...banoret qe protestonin ditën vinin naten dhe thonin bejeni tek toka jone...kete politizim qe ka patur kjo ceshtje bashkia nuk e ka patur ne keto dhjete vitet e fundit...shoqeria civile u be pjese e politikës dhe e segmeneteve te saj..pse ishte politike?! se po afronte fushata e duhej gjetur nje turme te bllokonte rrugen e te protestonte per gjera qe nuk kishin informacion...duhej qe qyteti te bllokohej dhe bashkia te bllokohej etj..

...ishin dy momente qe ndikuna ne rrezimin e projektiti....gjithcka u perdor politikisht populli njerezit media si dhe vendimi i qeverise per importin e plehrave ndikoi per keq pasi u tha se edhe ne Fier do te vinin plehrat per impiantin dhe se do te depozitoheshin mbetje nga qyete te tjera jashte Shqiperise..pra nje dizinformacion total...

✓ Duhet të kenë në qendër këndvështrimin e **specialistëve** të ndryshëm

Mendimi i ekspertit ka avantazhin të njihet si më i specializuar në komunitet dhe si i vetmi që mund të merret për bazë duke vendosur kështu autoritetin e tij në konsensusin ndërmjet palëve.

-...ekspertet e mjedisit nuk kane dhene asnjehere me detaje mendimin e tyre. Askush nuk e di se cfare mendojne realisht ata pasi nuk jane pyetur. Ne kemi specialistet tane dhe nuk duhet te pesim vetem nga specialistet e firmes apo te tjere....

-...mendoj se duhej te merrej per baze mendimi i specialisteve ...pasi nuk ka projekt dhe nuk ka investim qe t'i marrë mendim cdo qytetari vec e vec, e do apo nuk e do...dhe eshte veshtire qe te gjithë banoret te bien dakord per cdo investim qe bejme....

Siç u theksua edhe më sipër, rol shumë të rëndësishëm luan përfshirja e specialistëve përgjatë gjithë procesit. **Specializimi i procesit** duhet bërë i mundur në disa nivele:

✓ Trajtimit i situatës si një **emergjencë mjedisore** që kërkon zhjidhje profesionale

Identifikimi i situatës si një emergjencë shoqërore rrit percepsimin për nevojën e një ndërhyrje të specializuar duke vënë kështu dakort komunitetin dhe përfaqësuesit e

pushtetit qëndror dhe vendor. Natyrisht, që ky konsensus të jetë i qëndrueshëm, çdo vendimarrje e marrë nga ekspertët duhet të qëndrojë jashtë ndikimeve që kanë për qëllim të përdorë gjykimin profesional.

-...specialistet e kompanise kane bere tri takime me qytetaret...por se sa jane degjuar ata nuk di te them. Kur ne shpallen emergjencen mjedisore gjithë banoret ishin ok me ne dhe filluan te interesosheshin normalisht se si do zgjidhej por ne momentin qe u perdoren politikish ateherë filluan kontestimet....

-....shqetesimi per ngritjen e landfillit ishte i nevojshem...shpallja e vendimit te pare ne Keshillin Bashiak ishte per gjendjen e emergjences mjedisore dhe vend depozitimi u la ne dore te specialisteve te bashkise dhe ministries se mjedisit

✓ Përfshirja e **ekspertëve** kredibël në gjetjen e zgjidhjes ndaj situatës

Përfshirja e ekspertëve rrit kënaqësinë ndaj procesit, sheshon mosvarrëveshjet dhe ngre perceptimin e profesionalizmit në trajtimin e çështjeve.

-Une kam qene dhe kam pare landfillin ne Prage..por mund te them se kush do na e garantoje cilesine dhe standartin e ketij tonit..si qyetar e si anetare i shoqeërise civile, si popull nuk mund te garantojme se do te jemi teresisht të sigurt pa folur me pare specialistet e fushes, inxhinieret, kimiste, expertet..dhe kjo duhet te bere me nje transparence maksimale

-....specialistet menduan te zgjidhnin dy zona ne cdo njesi administrative per te mos lene shkak per nje vendim te njeanshem per njerë apo tjetren zone....ato qe plotesuan kushtet ishin 6 vende nga njesi te ndryshme administrative....kriteret ishin, larg zonave te banuara, pa ujra nentokesore dhe Pllyku u pa si zone qe i plotesonte keto kerkesa, por pas studimit u pa qe edhe ketu ujrë ishin afer siperfaqes...ndaj ende nuk është marrë asnjë vendim

-...nuk eshte vendosur asgje...gjithcka eshte ne leter pasi ne i vendosim bllok cdo investimi qe kerkohet te behet per te miren e qytetit dhe banoreve dhe kjo behet pasi politizohen gjerat...njerezit friksohen, perhapet informacion i shtermbeluar dhe nuk leme asnjehere te degjohen eksperitet, specialistet por merremi me fjale partish e forcash politike...

✓ Roli **mediator** i bashkisë përgjatë këtij procesi

Në të gjithë këtë proces është e rëndësishme për një impakt pozitiv, që të përcillet përshtyja mbi rolin ndërmjetësues të Bashkisë. Ajo nuk duhet të shihet kryesisht si një instancë vendimarrëse por si garanuese e mirëqënies së individëve në komunitet brenda një procesi ku vendimarrja vjen nga ekspertiza. Ky qëndrim shërben në rritjen e aleancës dhe konsensusit midis pushtetit vendor dhe komunitetit.

-...eshte i domosdoshem perpunimi i plehrave..ketu biem te gjithë dakord... per kete kemi luftuar qe te gjejme nje mesore sesi do te bashkepunojme ne dhe Bashkia që të na qetesojë per mosndotjen e ajrit dhe per rreziqet e tjetra qe do vijne nga ndertimi

-...ka qene nje shqetesim edhe i kryetarit te bashkise ceshtje e mbetjeve te impinatiti si do jene sa te rrezikshme etj etj..ai ka thirrur ekspertet e mjedisit dhe i ka pyetur se si do te behet me mbetjet, sa do te jene ato sa te rrezikshme etj dhe ata i kane dhene atij garanci maksimale..i gjithë shqetesimi yne eshte si ai i qytetareve qe teknologjia e impiantiti te jete maksimale, optimale dhe i gjithë problemi qendroin ne faktin se impianit duhet te jete sa me modern dhe ketu duhet te ndalemi dhe te jemi kerkues.

-...Bashkia ka per detyre te ofroje nje vend te pershtatshem dhe nuk eshte ajo qe inicicion kontraten koncesionare...ate e beri Ministria dhe firma. Bashki ka per detyre vetem te caktojë nje vend qe te mos demtojë banoret e cdo njesie administrative.....une di qe nuk ka leje per vazhdimin e projektiti...jemi ne fazen e gjetjes se nje vendi te pershtatshem

Një tjetër aspekt që konsiderohet i rëndësishëm është përfshirja e **medias dhe shoqërisë civile** përgjatë gjithë këtij procesi. Në këtë kuadër gjatë fokus grupit rezultojnë të rëndësishëm këto aspekte:

✓ **Prezenca e medias** në të gjitha fazat e procesit informues

Roli i media si një prezencë aktive në funksion të informimit qytetar dhe si një aktor asnjëanës që demaskon keqpërdorimet në mbrojtje të të drejtës së qytetarit për transparencë, është vendimtar që një process të perceptohet si funksional në të gjitha drejtimet. Një imazh i ndryshëm i medias penalizon ndjeshëm zhvillimet optimale të të gjitha fazave të procesit.

-...mbledhjet e keshill bashkiak jane bere te ditura ne media...eshte njoftuar 10 dite para per mbledhjen dhe ato kane qene te hapura...media ka qene e pranishme ne te gjitha mbledhjet e bera...

-...media ishte brenda ketyre mbledhjeve..... dhe roli i mediave ka qene i percipete pasi ka bere raportim selektiv...edhe ne si forum qytetar nuk jemi informuar sic duhet

✓ **Prezenca e shoqërisë civile** në të gjitha fazat e procesit informues

Shoqëria civile, e cila ka në qëllimet dhe funksionet e saj, mbrojtjen e interesave të komunitetit, e ka domosdoshmëri prezencën e saj në të gjitha kontekstet ku është e nevojshme përkrahja sociale. Një perceptim i kundër do të dëmtonte ndjenjën dhe besueshmërinë për një përfaqësi të mirë të komunitetit përball interesave të ndryshme që në këtë rast, do të perceptoheshin tërësisht politik apo/edhe financiar

-...ka patur edhe presence te individëve aktiv të komunitetit, si ndonje mesues biologji etj, por shoqatat jo, ato jane vetem brenda zyrave te tye...

✓ **Përdorimi i medias** për informim nga ekspertët

Roli i medias duhet të atashohet sa më shumë me atë të burimit të informimit sa më real dhe të ekspertizës me qëllim që të fitojë kredibilitet duke i ardhur në mbështetje komunitetit të gjerë.

-Perse nuk keni bere emisione ne tv apollon per te na bindur se impianti i Elbasanit eshte kaq modern e pa rrezik?!

...por une them se nuk ka patur asnje analize ne media.. asnje investigim kronike, reportazh sqarues per landifillin...

✓ **Përdorimi i shoqërisë civile** për informim nga ekspertët

Shoqëria civile pritet të përfaqësojë denjësisht zërin e qytetarit duke hulumtuar mbi ato përgjigje që do të rrisnin nivelet e ndërgjegjësimit komunitar

-....po keshtu nuk eshte punuar per sqarim edhe nga shoqria civile e qytetit dhe them se nga kjo e fundit nuk ka patur asnje kerkese per te 6 zonat se pse do të zhvillohet pikerisht atje, etj etj.

Së fundi, aspekt tjetër që rezulton i rëndësishm në rritjen e perceptimit të transparencës lidhet me informimin në **zhvillimin ekonomik dhe social** si rrjedhojë e kontratës. Në këtë kuadër është i rëndësishëm:

✓ **Informimi i plotë** mbi përfitimet ekonomike dhe sociale

Informimi mbi përfitimet ekonomike luan një rol pozitiv jo vetëm se parapërgatit dhe ushqen shpresën në komunitet për rritje të mirëqënies ekonomike si rezultat i investimeve strategjike, por edhe sepse shërben si një faktorë shtesë në rritjen e besueshmërisë ndaj politikave qeveritare dhe pushtetare në funksion të mirëqënies së tij.

-Une mendoj se do kete perfitime por duhet nje zgjidhje urgente dhe njerezit te jene me te qartë dhe me te informuar...na duhet te degjojme specialistet e vertete, informacioni duhej te ishte me transparent...

-....persa i perket impaktiti ekonomik mendoj se do te kete punesime ne infrastrukture rrugore dhe ne prodhimin e energjise qe do cliroje impianit ku ai do te jete me i lire per zonat pranë.

✓ **Konkretizime** sa të shpejta të projektit/projekteve

Debatet dhe diskutimet konstruktive duhet t`ja lënë vendin hapave konkret në realizimin e studimeve nga ekspertë të fushës. Sa të të përshpejtuar të jenë këto hapa dhe sa më në linjë me premtimet e ndërmarra në fazat paraprake, aq më shumë ndikojnë në rritjen e kredibiliteti komunitar ndaj politikave për zhvillim ekonomik të pushteti vendor

-...po shikohen te gjashtë variantet e mundshme me seriozitet dhe nuk mund ta themi qe tani se sa do te jete perfitimi ekonomik per aq kohe sa gjithcka eshte ne letere.. sot qe po flasim nuk ka nje studim dhe ju garantoj se ne cdo marreveshje mes ministrisë dhe bashkise nuk do te leme jashte njerezit.

-Nese do te ndertohet impianit do te punësohen 114 persona..do te kete edhe benefite te tjera por eshte shpejt te themi per aq kohe qe ai eshte ne leter dhe eshte ende si projekt. Nuk mund te japim detaje persa i perkete benefiteve te tjera ekonomike...

Bashkia Divjakë

Në ndryshim nga Bashkia Fier, situata në Bashkinë Divjakë paraqitet disi më e veçantë. Në këtë Bashki situata me kontratën koncesinare prek një problematikë të hershme që i referohet viti 2010. Më konkretisht, bëhet fjalë për dhënien me koncension të 338 kabinave të plazhit të Divjakës tek qeramarrës të ndryshëm, duke pretenduar në mirëmbajtjen dhe rritjen e standardeve në shërbimin ndaj turistëve. Nisur nga këto karakteristika, rezultatet e fokus grupit evidentojnë një sërë problematikash të veçanta që në ndryshim nga Bashkia Fier, nuk prekin shumë aspekteve mjedisore dhe sociale, por ato të abuzimeve ligjore dhe ekonomike të vënë re ndër vite. Impakti mjedisor dhe social i kontratës për këtë Bashki i referohet kryesisht mungesës së kanalizimeve dhe infrastrukturës në përpunimin e mbetjeve të cilat në çdo rast rezultojnë se grumbullohen rregullisht. Ndërkaq, situata e zhurmave dhe vibrimeve gjatë verës paraqitet e menaxhueshme pasi aktiviteti i kabinave rezulton i mbajtur nën kontroll dhe i limituar gjatë ditës. Ato çka shihet si shqetësuese në rastin konkret janë transparenca në trajtimin e çështjeve ligjore dhe ekonomike-financiare në lidhje me kontratat të cilat rekomandohet të mbahen parasysh me

qëllim rritjen e kënaqësisë dhe vlerësimit pozitiv të komunitetit ndaj performancës dhe transpatencës të pushtetit vendor.

Sipas të dhënave, thelbësore mbetet menaxhimi i **abuzimeve ligjore** duke ju referuar disa aspekteve të lidhura me të:

✓ **Parregullsi ligjore** në trajtimin e kontratës

I gjithë procesi i dhënies me qera dhe i privatizimit të kabinave të plazhit ne Diviakë shihet si i realizuar në mënyrë të pa ligjshme nga pushtevi i vjetër vendor dhe për këtë situata konsiderohet si një shkelje flagrante që meriton të gjejë zgjidhje në gjykatën administrative

-...shume nga ato jane marre me qera nga njerez qe nuk jane nga Divjaka por nga Durreësi, Lushnja etj etj....dhe gjithçka eshte bere ne fshehtësi te plote...

-Sipas kontakteve me qytetaret flitet se ne ate kohe, banoreve te Divjakës u jane ofruar ti merrnin me qera me nje cmim me te larte se sa banoreve te Lushnjes....

-Te gjithë ata qe kane marre kabinat jane njerez me pushtet që kanë abuzuar me kontratat...

-Ka patur shume abuzime ne lidhje me cmimet dhe problem qendron tek keqperdorimi i pushtetit te Bashkise se asaj kohe...

-Kater objekte jane privatizuar dhe tek të gjitha ka patur shkelje ne privatizimin e tyre....çeshtja eshte cuar deri ne Gjykatën Administrative te Vlorës nga Bashkia Divjakë...

-Për shkeljet ligjore me keto kontrata meritojnë të shkojnë në gjyq civil dhe per kete qytetaret jane shume te interesuar...

✓ Mungesë azhornimi në **ndryshimet kontraktuale**

Kontrata koncesionare për kabinat e plazhit të Divjakës ka pësuar ndryshime nga qeramarrja në privatizimin e tyre për të cilat opinion publik rezultoi i pa azhornuar. Për këtë përgjegjës bëhet pushteti aktual vendor

-Nuk ka patur transparence fare ne kete drejtim. Po nderkohe edhe sot nuk ka transparence per situat e gabinave sa jane me qera dhe sa jane privatizuar

Një çështje e dytë thelbësore lidhet me **informimin publik** duke e parë në këto aspekte:

✓ Mungesë **zyrtarizimi** i informimit publik

Përpaqësues të komunitetit e vënë theksin tek natyra informale e informimit mbi kontratat duke u preferuar përcjellja gojë më gojë mes qytetarëve dhe jo me instrumenta si lajmërimet, njoftimet, afishimet, faqe interneti, FB ose media. Përgjegjës për formën e shpërndarjes së informacionit mbetet pushteti i vjetër vendor

-Ne si qytetarë nuk kemi qene te interesuar pasi këtë gjë e kemi degjuar goje me goje dhe nuk ka patur ndonje informacion te sakte apo ndonje degjese publike nga Bashkia...

-Informacioni ka kaluar goje me goje dhe jo ne menyre zyrtare

✓ Mungesë **azhornimi** në informimin publik

Sot, pas shtatë vitesh qeradhënie të kabinave të plazhit në Divjakë opinion i komunitetit gjendet i pa informuar për ndryshimet. Përgjegjës për shpërndarjen e informacionit mbi ndryshimet kontraktuale është pushteti vendor aktual

-Aktualisht akoma nuk kemi dijeni nese gabinat jane serish me qera apo te privatizuara

-Media ka informuar per qiradheniene vetëm në 2010...më tej nuk dihet gjë....

-....edhe nga takimet me qytetaret nuk ka patur dijeni ne lidhje me privatizimin e kabinave...

Së fundimi, abuzimet ekonomike-financiare janë në çështje e tretë me inters për t'u trajtuar në këto aspekte:

✓ **Parregullsi ekonomike** në menaxhimin e kontratave

Kontratat mbi dhënien me qera dhe privatizimin e kabinave të plazhit sjellin përfitime ekonomike për të cilat, qytetarët që i kanë, shpesh nuk paguajnë detyrimet e zakonshe financiare kundrejtë Bashkisë së Diviakës. Kjo konsiderohet si një shkelje flagrante për të cilën bashkia duhet të marrë masa të menjëhershme

-Kater objekte jane privatizuar dhe ata qe i kane blere nuk kane paguar detyrimet financiare...

-Ekzistojne probleme me mbledhjen e taksava pasi banoret qe kane privatizuar nuk paguajne taksa prane bashkise..

✓ **Lokalizim i perfitimeve** nga kontratat koncesionare

Përfitimet ekonomike nga shfrytëzimi turistik i këtyre kabinave shihen si të fokusuar vetëm tek qeramarrësi apo pronari i tyre nga momenti që menaxhimi i tyre ka mbetur kryesisht familjar. Duhet marrë masa për shfrytëzimin eficient të tyre me qëllim që efekti i përfitimeve ekonomike të zgjerohet më tej tek biznesi tjetër i zonës dhe popullsia lokale.

-Efekti ekonomik vihet re gjate veres kur vijne pushuaes qe i perdorin ato ose i marrin me qera nga ata qe i kanë. Sot ne 80 perqind e gabinave jane investuar nga ata qe I kane marre me qera ndersa tek 20 perqindëshi tjetër nuk eshte vene dore dhe jane të rrenuar....

-Dhenia me qera e tyre ka impakt në perfitime por jo shume te medha tek bizneset e tjera të zones por vetëm tek qeramarrësit e tyre

-Këto kabina nuk ka rritur shume punesimin e banoreve lokale pasi pergjithseisht kanë mbetur në një përdorim familjar.

KAPITULLI VII

1.0 KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

1.1 KONKLUSIONE MBI ANALIZËN E DOKUMENTUAR DHE STUDIMORE TË KONTRATAVE KONCESIONARE

Në këtë paragraf do të parashtrihen një sërë konkluzionesh që janë rezultat i punës së dokumentuar dhe studimore mbi transparencën ndaj qytetarëve në lidhje me kontratat koncesionare në bashkinë e Fierit dhe të Divjakës. Një sërë çështjesh që i referohen aspekteve juridike, sociale, mjedisore dhe ekonomike janë parë si thelbësore në perceptimin e transparencës së qytetarëve lidhur me këto kontrata koncesionare. Më specifikisht, në lidhje me kontratën koncesionare të bashkisë Fier, konkludohet se:

- ✓ Lidhur me vendin që është propozuar për ndërtimin e inceneratorit, duhet një punë më e madhe nga Bashkia për të informuar qytetarët, veçanërisht ata që banojnë në zonën afër projektit, mbi benefitet, garancitë për jetën edhe shëndetin e tyre apo për ndonjë pasojë të mundshme.
- ✓ Vendimet mbi djegien e plehrave në vend të riciklimit të tyre bien në kundërshtim me legjislacionin shqiptar të menaxhimit të mbetjeve pasi kjo shumëfishon kostot dhe sipas ekspertëve dhe aktivistëve, rrit rreziqet për mjedisin dhe shëndetin e qytetarëve.
- ✓ Inceneratori bie ndesh me planin kombëtar për menaxhimin e mbetjeve të miratuar nga qeveria shqiptare, i cili i jep përparësi parandalimit, ripërdorimit dhe riciklimit përpara asgjësimit të mbetjeve si edhe parashikon trajtimin e tyre nëpërmjet landfildeve.
- ✓ Mugesia e përsëritur e përgjigjeve, nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Bashkisë Fier, ndaj shkresave dhe ankesave të organizatës “Open Doors”, rezulton në shkelje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” dhe Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Sa më sipër, këto dy institucione duhet të jenë më transparente në lidhje me informacionet mbi kontratën koncesionare.
- ✓ Mediatizimi i faktit që kompanitë fituese koncesionare për riciklimin e plehrave në Fier, përkatësisht kompania IT-e dhe shoqëria italiane “Energy 2SRL” e specializuar në “Green Energy” pa lidhje me riciklimin, kanë fituar garën për kontratën koncesionare me afat 6

vjeçar, konsiderohet shkelje pasi është bërë pa transparencë me publikun dhe në mënyrë shumë të shpejtë.

- ✓ Kostoja për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Fierit dhe prodhimit të energjisë, është disa here më e lartë se kostot që rezultojnë nga ndërtimi i impianteve të tilla në Bashkimin Europian.
- ✓ Kostoja e përllogaritur 7,27 milion euro për Mv pas amortizimit të veprës do të fillojë pas vitit të 6-të të operimit kur edhe impianti i përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Fierit dhe prodhimit të energjisë do të kalojë në pronësi publike. Janë pikërisht këto kosto që e nxjerrin pa leverdi dhe me humbje çdo vit operimin e impiantit.
- ✓ Mënyra e financimit të veprës ku, koncesionari financohet pa nisur ende punën në terren, mund të kishte privilegjuar një formë tjetër, duke hequr dorë nga partneriteti publik privat (PPP) dhe duke zgjedhur formën e prokurimit publik. Autoriteti kontraktues mund të financohej me kredi të butë, ndërkohe që përfitimet mund të nisnin që në vitin e parë të operimit të impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane dhe prodhimit të energjisë. Kjo do të rriste dhe konkurrueshmërinë me projekte alternative.
- ✓ Forma koncesionare PPP është kritikuar edhe nga pëfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar në Tiranë. Sipas shefit të FMN-së në Tiranë, z. Jens Reinke, thuhet të gjitha koncesionet jepen pa një analizë të qartë mes kostove që paguajnë qytetarët dhe përfitimeve që ato sjellin. Sipas tij:- “Duhet të kemi një listë konsistente të projekteve prioritare që bëhen me koncesion dhe jo vetëm. Çdo koncesion, përfshirë ato të mëdhatë e dhëna së fundmi, dalin nga një proces jo shumë formal. Së dyti, duhet të kemi një njësi të fortë në ministrinë e financave që bën analizën e kosto-përfitimeve për çdo projekt që të ketë fuqinë të refuzojë projektet pa leverdi....Programi i investimeve të qeverisë duhet të jetë konsistent dhe i mirëmbuar. Ai duhet të mbajë parasysh përfitimet totale në rrjetin e infrastrukturës që vijnë nga investimet e ndryshme. Kjo nuk mund të ndodh kur qeveria thjesht miraton propozimet e pakërkuara që vijnë nga privatët, por vetëm kur ajo identifikon strategjinë e saj dhe tenderon publikisht ato projekte të cilat janë përzgjedhur se kanë përfitimet më të mëdha.”
- ✓ Blerja e energjisë të prodhuar nga impianti i përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Fierit nga kompanitë publike të energjisë në dy variante, si me çmimin e përllogaritur në studimin e fizibilitetit 63 Euro për kWh, ashtu dhe në metodologjinë e miratuar nga

qeveria me VKM nr. 27, 17.01.2018, ia siguron koncesionarit tregun e energjisë por nga ana tjetër rondon mbi financat e një kompanie publike.

- ✓ Në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve vendosja e inceneratoreve këshillohet në afërsi të qendrave ku ka fabrika apo industri dhe që mund ta shfrytëzojnë lehtësisht energjinë e prodhuar nga djegia e mbeturinave për qëllime industriale të prodhimit me kosto të ulta transmetimi.
- ✓ Qytetarët nuk rezultojnë të kënaqur me qëndrimin e bashkisë në lidhje me kontratën koncesionare. Më konkretisht, të pyetur mbi përdorimin e tokës ku do të ndërtohet impianti, qytetarët e konsiderojnë bashkinë me qëndrim imponues, të fshehtë/ të pa paqartë/ jo transparent ose të pa paqëndrueshëm dhe me raste të frikësuar.
- ✓ Qytetarët i tremben abuzimeve ligjore mbi kontratën koncesionare. Në përceptimin publik, respektimi i ligjit lidhet shumë me korrektesën e pushtetarëve, të cilët shihen si parësor për abuzimet ligjore.
- ✓ Përgjithësisht qytetarët janë pesimist në lidhje me ndikimet positive të kontratës në zhvillimin e zonës. Qytetarët mendojnë se kontrata do të sjellë aspak/pak ose disi të ardhura ekonomike për zhvillim.
- ✓ Qytetarët gjykojnë se media, shoqëria civile, individ të komunitetit dhe sipërmarrës kanë qenë vetëm pak/aspak ose disi aktiv në mbrojtje të interesave të tyre.
- ✓ Qytetarët rezultojnë të shqetësuar mbi ndotjen e përgjithshme të mjedisit si pasojë e zbatimit të kontratës koncesionare. Përceptimi mbi ndotjen mjedisore është i lidhur kryesisht me ndotjen e ajërimit. Shqetësimi mbi çështjen e vibrimeve dhe të zhurmave si edhe rëndimit të trafikut nga automjetet e rënda, nuk konsiderohet i rëndësishëm.
- ✓ Qytetarët nuk mendojnë se do të ketë ndryshime thelbësore në rritjen e punësimit dhe kualifikimit të banorëve nisur nga kontrata koncesionare. Pavarësisht informacioneve të vaktuara mbi të ardhurat që do të gjenerojë bashkia, ata gjykojnë se kontrata do të sjellë aspak/pak ose disi të ardhura për ekonominë lokale. Faktor i rëndësishëm në këtë paragjykimin qytetar është edhe mungesa e informimit të duhur nga bashkia.

Më specifikisht, në lidhje me kontratën koncesionare të bashkisë Dvjakë, konkludohet se:

- ✓ Bashkia Dvjakë, ka dhënë me qera një sërë pasurish që janë ekskluzivisht nën administrimin e pushtetit vendor. Të gjitha këto pasuri, janë të regjistruara në ZVRPP

Lushnjë si pronë e Bashkisë Divjakë pasi transferuar në pronësi të Bashkisë Divjakë me Vendimin nr. 499, date 19.07.2006 të Këshillit të Ministrave dhe në këtë mënyrë është atribut i Këshillit të Bashkisë Divjakë, për tjetërsimin ose jo të tyre, në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe jo i Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, siç është vepruar në rastin konkret. Sa më sipër është demonstrim i një abuzim të rëndë.

- ✓ Bashkia Divjakë nuk ka mundur dot të vendosë në vend të drejtën ligjore të shkelur duke ju drejtuar gjykatës kompetente. Ajo jo vetëm që nuk ka arritur dot të mbledhë një pjesë të detyrimeve të pashlyera nga qeradhënia e kabinave të plazhit, por as nuk ka mundur dot të ngrejë një padi duke kërkuar pavlefshmërinë e kontratave të shitjes së gabinave.
- ✓ Realizimi i të ardhurave për Bashkinë Divjakë, nga momenti i lidhjes së kontratave deri më sot për objektet e dhëna me qera, (Kabina Plazhi lidhur në 2010), sipas përcaktimit të saktë të marrë nga zyra e Tatim Taksave dhe Auditimit të Brendshëm si edhe me rekomandimin e KLSH-se është në vlerën 12,462.962 lek.
- ✓ Rasti i dhenies me qera është opsioni optimal për të krijuar të ardhura në bilancin e bashkisë, krahasuar me mosvënien në shfrytëzim dhe mirëmbajtjen e këtyre asetëve nga ana e Bashkisë. Kjo mënyrë (e dhenies me qera partnereve publik) është mënyra më efektive për të zgjidhur rastet e mungesave të fondeve buxhetore në dispozicion si dhe plotësimin e kërkesave të shërbimeve publike kohore. Kjo sjell rritjen e cilësisë së shërbimeve publike të ofruara dhe rrit nivelin e aksesit të publikut në to, duke sjelle mbylljen e boshlliqeve financiare
- ✓ Dhenia me qera e këtyre kabinave fut teknologjinë dhe inovacionin e sektorit privat (qeradhënesve) në drejtim të ofrimit të shërbimeve më të mira publike.
- ✓ Menaxhimi nga ana e bashkisë Divjake ka shfaqur shpesh herë dobësi të theksuara. Menaxhimi publik, me defektet sistematike të ndikuara nga mungesa e stabilitetit të burimeve njerëzore, ndërhyrjet e faktorëve politikë, kanë qenë shpesh inferior krahasuar me menaxhimin e partnerëve privatë (qeramarrësve) të cilët veprojnë si sipërmarrës ekonomikë.
- ✓ Keto objekte kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme dhe në nivele të kënaqshme. Në shumë raste, niveli i mirëmbajtjes së tyre nga sektori publik, rezulton i papërshtatshëm,

duke sjellë si pasojë uljen e cilësisë së ofruar. Mirëmbajtja e pa planifikuar dhe e pa zbatuar në mënyrë efektive është një nga problematikat e sektorit publik.

- ✓ Ndërhyrja e partnerëve privatë,(qeramarrësve), kur kryhet në mënyrë të studiuar dhe me mekanizmat e duhur të monitorimit publik, përmirëson ndjeshëm situatën në lidhje me mirëmbajtjen cilësore.
- ✓ Nisur nga fakti se “zona e plazhit Divjake” nuk ka ende një plan urbanistik të miratuar nga KRRTRSH-ja në të cilin mund të parashikoheshin objekte të ndryshme (rrugë, kënd lojrash etj), përfaqësues të bashkisë i kanë drejtuar një sërë shkresash institucioneve përkatëse me qëllim mosprivatizimin e këtyre objekteve por pa arritur në asnjë rezultat konkret.
- ✓ Shumë kabina plazhi janë marrë me qera nga njerëz që nuk janë nga Divjaka por nga Durrësi, Lushnja etj, dhe gjithçka është bërë në fshehtësi të plotë
- ✓ Banorët e Divjakës janë diskriminuar në lidhje me qeramarrjen e këtyre kabinave, duke ju ofruar kosto më të larta shërbimi. Sa më sipër, është një diskriminim për shkaqe sociale apo krahinore duke shkelur hapur nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
- ✓ Banorët e Divjakës nuk rezultojnë të kënaqur me qëndrimin e bashkisë në lidhje me kontratën koncesionare. Qytetarët i tremben abuzimeve ligjore mbi kontratën koncesionare. Në perceptimin publik, respektimi i ligjit lidhet shumë me korrektesën e pushtetarëve, të cilët shihen si parësor për abuzimet ligjore.
- ✓ Përgjithësisht Banorët e Divjakës janë pesimist në lidhje me ndikimet positive të kontratës në zhvillimin e zonës. Banorët e Divjakës mendojnë se kontrata sjellë aspak/pak ose disi të ardhura ekonomike për zhvillim.
- ✓ Banorët e Divjakës gjykojnë se media, shoqëria civile, individ të komunitetit dhe sipërmarrës kanë qenë vetëm pak/aspak ose disi aktiv në mbrojtje të interesave të tyre.
- ✓ Qytetarët nuk rezultojnë të shqetësuar mbi çështjen e ndotjes nga mënyra e grumbullimit të mbetjeve, vibrimet dhe zhurmat si edhe nga rëndimi i trafikut nga automjetet.
- ✓ Qytetarët nuk mendojnë se ka ndryshime thelbësore në rritjen e punësimit dhe kualifikimit të banorëve nisur nga kontrata koncesionare. Pavarësisht informacioneve të vakta mbi të ardhurat që gjeneron bashkia, ata gjykojnë se kontrata sjellë aspak/pak ose disi të ardhura për ekonominë lokale. Faktor i rëndësishëm në këtë paragjykimin qytetar është edhe mungesa e informimit të duhur nga bashkia.

1.2 REKOMANDIME MBI ANALIZËN E DOKUMENTUAR DHE STUDIMORE TË KONTRATAVE KONCESIONARE

Mbi bazën e një pune të detajuar hulumtuese të dokumentave të vëna në dispozicion si edhe të rezultateve dhe analizave studimore mbi perceptimin qytetar lidhur me dy kontratat koncesionare të bashkisë së Fierit dhe Divjakës, parashtrohen një sërë rekomandimesh të natyrës juridike, socialë, mjedisore dhe ekonomike që do të përmirësonin punën, perceptimin e transparencën dhe përfshirjen qytetare lidhur me to. Më poshtë renditen këto rekomandime për përmirësimin e transparencës ndaj qytetarëve dhe çështje të lidhura me aspektet ekonomike, mjedisore dhe ligjore në lidhje me kontratën koncesionare të Fierit:

Transparenca

- ✓ Të merren masa nga Bashkia Fier për informimin qytetarët, veçanërisht ata që banojnë në zonën afër projektit, mbi benefitet, garancitë për jetën edhe shëndetin e tyre apo për ndonjë pasojë të mundshme.
- ✓ Të merren masa nga Bashkia Fier që të azhurnojë dhe përditësojë faqen zyrtare elektronike me informacionin e duhur në lidhje me çdo vendimarrje, veçanërisht me ndërtimin e inceneratorit, që është një vepër me rëndësi kombëtare, afatgjatë dhe me kosto shumë të madhe.
- ✓ Të merren masa nga Bashkia Fier për të trajnuar punonjësit e saj në lidhje me rregullat e bashkëpunësimit në projektet publike, informimit dhe transparencës së publikut në lidhje me vendimarrjen e pushtetit lokal, me qëllim efikasitetin e administratës që duhet të jetë gjithnjë në shërbim të qytetarëve.
- ✓ Të merren masa nga Bashkia e Fierit për të orientuar qytetarët nëpërmjet tabelave ku ata mund të marrin informacion të kategorizuar dhe lehtësisht të gjetshëm mbi kontratën.
- ✓ Të merren masa që angazhimi i komunitetit në dëgjuesat publike të respektojë këto karakteristika: të jetë i hapur për të gjithë, të organizohet në mënyrë periodike ku të interesuarit të njoftohen paraprakisht dhe ku informacioni të jetë i plotë dhe jo kontradiktor; të kenë në qëndër këndvështrimin specialist dhe të mos kenë, për asnjë arsye, ngjyrim apo përdorime politike

- ✓ Të mere masa që “Specializimi i procesit” të bëhet i mundur në disa nivele: në trajtimin e situatës si një emergjencë mjedisore që kërkon zhgjidhje profesionale; në përfshirjen e ekspertëve dhe në rolin mediues të bashkisë përgjatë gjithë këtij procesi
- ✓ Të merren masa për përfshirjen e medias dhe shoqërisë civile përgjatë gjithë këtij procesi. Kjo kërkon: prezencën e medias dhe të shoqërisë civile në të gjitha fazat e procesit informues, lobues dhe advokues; përdorimin e medias dhe të shoqërisë civile për informim nëpërmjet ekspertëve
- ✓ Të merren masa për rritjen e perceptimit të transparencës mbi avantazhet ekonomik dhe sociale të kontratës. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet: informimit të plotë mbi përfitimet ekonomike dhe sociale; konkretizimeve sa më të shpejta në realizimin e projektit të inceneratorit dhe landfillit.
- ✓ Të merren masa për informimin e publikut në lidhje me terma juridikë të kontratës koncesionare. Ky informim duhet të jetë i plotë dhe i kuptueshëm nga të gjithë përtej nivelit arsimor. Ai gjithashtu duhet të transmetohet në të gjitha aspektet e tij duke mos lënë vend kështu për keqinterpretime.

Aspektet ekonomike, mjedisore dhe ligjore të Kontratës

- ✓ Mundësitë e ndërhyrjes për ta bërë projektin më të pranueshëm nga ana financiare renditen si më poshtë:
 - Të vendoset gate fee/pagesa për pranimin e mbetjeve që do të grumbullohen nga bizneset në mënyrë që të rriten të ardhurat
 - Të shihet mundësia e sigurimit/blerjes së impiantit me vlerë më të ulët por pa kompromentuar treguesit teknologjik të tij.
 - Të rriten kapacitetet e përpunimit të mbetjeve dhe kjo e shoqëruar me rritjen e kapaciteteve të prodhimit të energjisë, pra të shtohet kapaciteti i MW të impiantit, duke u mbështetur në kostot e përvojave dhe projekteve të ngjashme europiane.
 - Të negociohet për sigurimin e një tregu energjie me leverdi për sasitë e prodhuara nga impianti. Në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve vendosja e inceneratorëve këshillohet në afërsi të qendrave ku ka fabrika apo industri për shfrytëzimin e energjisë së prodhuar nga djegia e mbeturinave për

qëllime industriale të prodhimit. Kjo do të siguronte treg të sigurt për shitjen e energjisë dhe kosto të ulta për transmetimin e kësaj energjie duke ulur kështu çmimin për kWh të prodhuar.

- Të punohet për gjetjen e tregjeve me leverdi për shitjen me çmime sa më të larta të metaleve që prodhohen gjatë djegies së mbeturinave
- ✓ Ndërtimi i landfillit duhet të jetë opsioni final i asgjësimit sipas planit të menaxhimit të mbetjeve, pasi në krahasim me inceneratorët ata janë më të lirë dhe kanë kosto më të ulët operimi. Trajtimi mbetjeve nëpërmjet kompostimit në landfille, për Bashkinë Fier shihet si një alternativë më e sigurt edhe nga ekspertët ekologjist.
- ✓ Ministria e Mjedisit dhe Bashkia Fier rekomandohen të zbatojë metodën “Zero Mbetje”, sikurse shumë vende të Europës që kanë gjetur zgjidhje në menaxhimin e mbetjeve
- ✓ Monitorimi i vazhdueshëm që konsiston në:
 - Verifikimi i punës gjatë kryerjes të çdo operacioni për të arritur objektivat e planit.
 - Evidentimi i efekteve eventuale negative për të ndërhyrë në korigjimin e tyre.
 - Kontrolli periodik i strukturave ligjzbatuese në lidhje me respektimin e procesit teknologjik të punës në incenerator dhe landfill.
 - Promovimi i një pjesëmarrje aktive të komunitetit me synim sensibilizimin për kujdesin ndaj mjedisit.

Respektimi i të gjitha këtyre etapave dhe aspekteve thelbësore, do të bëjë të mundur realizimin e Planit rajonal të menaxhimit të mbetjeve, Planit të kujdesit për Ujin, Planit për kujdesin e cilësisë së ajrit, kujdesin për biodiversitetin dhe peisazhin.

Për përmirësimin e transparencës ndaj qytetarëve dhe çështjeve të lidhura me aspektet ekonomike, mjedisore dhe ligjore në lidhje me kontratën koncesionare të Divjakës rekomandohet:

Transparenca

- ✓ Te merren masa për pasurimin e faqes zyrtare të Bashkisë Divjake me të gjithë informacionin e nevojshëm për komunitetin.
- ✓ Të merren masa për informimin e opinionit publik mbi çdo ndryshim që ka pësuar kontrata koncesionare nga qeramarrja në privatizimin. Për këtë, përgjegjësia kryesore i mbetet pushteti vendor aktual

- ✓ Të merren masa për dhënien e informacionit jo vetëm nëpërmjet faqes zyrtare të Bashkisë Divjake, por edhe në mënyra tradicionale nëpërmjet afishimit dhe takimeve komunitare
- ✓ Të merren masa që informimi publik të jetë sa më formal (zyrtar) dhe jo të përcillet gojë më gojë mes qytetarëve. Për këtë duhen shfrytëzuar në maksimum instrumentat si lajmërimet, njoftimet, afishimet, faqja e internetit, FB ose media. Përgjegjës për mënyrën e shpërndarjes së informacionit mbetet pushteti vendor
- ✓ Të përmirësohet koordinimi mes institucioneve/njësive administrative dhe bashkisë Divjake me komunitetin

Aspektet ekonomike, mjedisore dhe ligjore të Kontarës

- ✓ Organi administrativ rekomandohet se duhet të vendosë në vend të drejtën ligjore të shkelur duke ju drejtuar me padi gjykatës kompetente për mbledhjen e një pjese të detyrimeve të pashlyera nga qeradhënia e kabinave të plazhit si edhe për të kërkuar pavlefshmërinë e kontratave të shitjes.
- ✓ Bashkia Divjakë duhet të administrojë më mirë situatën me qëllim që banorët e Divjakës mos diskriminohen në krahasim me banorë të qyteteve të tjera përreth.
- ✓ Në kabinat e rrënuara Bashkia Divjakë duhet të ndërhyjë menjëherë duke mundësuar restaurimin e tyre dhe kthimin në gjendjen e mëpashme për të qenë të shfrytëzueshme
- ✓ Kontratat mbi dhënien me qera dhe privatizimin e kabinave të plazhit sjellin përfitime ekonomike për të cilat qeramarrësit dhe pronarët nuk paguajnë detyrimet financiare. Kjo konsiderohet një shkelje flagrante për të cilën bashkia duhet të marrë masa të menjëhershme
- ✓ Përfitimet ekonomike nga shfrytëzimi gjatë sezonit turistik të këtyre kabinave, shihen si të lokalizuara vetëm në duart e qeramarrësit dhe pronarëve të tyre, kjo pasi menaxhimi i tyre ka mbetur kryesisht familjar. Duhet marrë masa për shfrytëzimin eficient të tyre me qëllim që përfitimet ekonomike të zgjerohen më tej tek biznesi i zonës dhe popullsia lokale
- ✓ Rekomandohet gjerësisht realizimi nga bashkia i analizës së riskut e cila garanton përfshirjen në analizën financiare dhe ekonomike të identifikimit dhe vlerësimit të elementëve të riskut të kontratës. Identifikimi i risqeve shërben gjithashtu për hartimin e strategjive për menaxhimin e riskut si edhe për ndarjen dhe alokimin e risqeve midis partnerit publik dhe atij privat.

✓ Referencat

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Fondacioni për Shoqëri të Hapur. (2008). Praktikrat e mira rajonale mbi pjesëmarrjen komunitare në qeverisjen vendore. Tiranë .

Kontrata e Konçesionit “Për ndertimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë”.

Ligji 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar; Ligji Nr. 9663, datë 18.12.2006, “Për koncesionet”, i ndryshuar me: Ligjin nr. 9995, date 22.09.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9663”, datë 18.12.2006 “Pë.

Ligji nr. 10137, datë 11.5.2009, “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 10157, datë 15.10.2009, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar.

Ligji nr. 10281, date 20.5.2010 “Për miratimin e aktit normativ me fuqine e ligjit nr. 1, datë 05.05.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9663 datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar.

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Plan biznesi “Dhënia me konçesion e ndërtimit administrimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhim energjie, gusht 2016.

Raport i KLSH-së i miratuar me Vendimin nr. 179, datë 20.12.2017 të Kryetarit të KLSH, si dhe për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 779/11, datë 20.12.2017, “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet për Auditimin e Përputhshmërie dhe rregullshmërie ”.

Studim Fizibiliteti, “Ndërtimi dhe Administrimi i impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimi i energjisë” maj 2016, gjithsej 130 faqe.

Studimin ekonomik – financiar, “Ndërtimi i impiantit të përpunimit dhe vendepozitimit të mbetjeve urbane Qarku Fier”. Tiranë – Janar 2016.

Udhëzim nr. 1738, datë 12.03.2015 “Mbi kriteret e studim projektimit për rehabilitimin e vendepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e lëndfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane”.

Udhëzimi Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Urdhër i Ministrit të Mjedisit, Nr. 751, Nr 6869 Prot, datë 25.11.2015. “Ngritjen e Komisionit për Dhënien e Konçesionit, Partneritetit Publik Privat me Objekt, “Ndërtimin dhe Administrimin e Impiantit të Trajtimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë” .

Urdhër Nr. 315, datë 15.12.2017, Nr 1481/1 Prot datë 15.12.2017, Komisioneri për të Drejtën e Informimit.

Urdhër nr. 751, datë 25.11.2015 “Për ngritjen e komisionit për dhënien me konçesion/partneritet publik priivat me objekt “Ndërtimin dhe administrimin e impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë”.

Vendim i Këshillit të Ministrave “Rregullat për koncesionet” VKM Nr. 27, datë 19.1.2007, “ Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies me koncesion”.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 608, datë 17.09.2014 “Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 19.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar për klasifikimin e mbetjeve” të ndryshuar.

Vendim Nr 341, datë 04.05.2016, “Për miratimin e bonusit në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë, për dhënie me konçesion për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 175, datë 19.01.2011“Për miratimin e strategjisë kombëtare për menaxhimin e mbetjeve dhe të planit kombëtar për menaxhimin e mbetjeve”.

VKM nr. 121, datë 22.2.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin 469, datë 16.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për caktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave procedurave të koncesion.

VKM Nr. 150, datë “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), ndryshuar.

VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 739, datë 01.07.2009, VKM nr. 54, datë 05.02.2014, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016, VKM nr. 693, datë 05.10.2016.

VKM nr. 469, date 16.06.2010 Për miratimin e “Rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura”.

VKM Nr. 575, datë 10.7.2013, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/Partneritet Publik Privat”.

VKM Nr. 576, datë 10.7.2013, “Për miratimin e rregullave për identifikimin, vlerësimin dhe dhënien e koncesioneve për hidrocentralet”.

VKM Nr. 634, datë 1.10.2014, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/Partneritet Publik Privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”, ndryshuar.

VKM. nr. III, date 09.03.2007 “Për krijimin e grupeve të punës për identifikimin dhe dhënien me koncesion”.

Vlerësimi i komunitetit për qeverisjen lokale 2016, Bashkia Fier”, projekti i USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) në Shqipëri.

(ATRC), Q. e. (Nëntor 2012). Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje në nivel lokal, Prishtinë.

Agjencia e prokurimit publik, Buletini nr.38 datë 26.09.2016.

- Analizë e kostove për energjinë e biomasës, International Renewable Energy Agency, Renewable Energy Technologies: Cost Analysis Series, Volume 1: Power Sector Issue 1/5 Biomass for Power Generation.
- Bashkia Fier, Projekt i USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit. (2016, Shkurt). Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit të Territorit për Bashkinë Fier.
- Çinaj, N. (2014). Prirjet e transformimit social-ekonomik të qarkut të fierit në kuadër të zhvillimeve të reja rajonale. Tiranë: Në kërkim të gradës shkencore doktor.
- ECAT, REC. Strategjia Rajonale e Zhvillimit të Qarkut Fier. Shtator 2003.
- Ermanno Barni, Pasquale De Stefanis, Vito Iaboni. Valutazione del Costo di Investimento del Termovalorizzatore di Acerra, 2010.
- Evans, G. W., & Cohen, S. (2004). Environmental stress. In Spielberger, C. (Ed.). Encyclopedia of applied psychology. 1 (pp.815–824).
- Fier, I. T. (2016). Studim Fizibiliteti i impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Fierit dhe prodhimi i energjisë.
- Folkman Susan, Lazarus Richard S., Pimley Scott, Novacek Jill. (1987, Jun). Age differences in stress and coping processes . Psychology and Aging, Vol 2(2), pp. 171-184.
- Hammen, C. (2005). Stress and depression. Annual Review of Clinical Psychology, Vol.1, pp. 293-319.
- Hans Selye, M. (1956). The Stress of Life. New York: McGraw-Hill Book Company.
- Hartay. E., Fondi i Kombeve të Bashkuara për Demokraci. Përktheu nga gjuha angleze: conference interpretation and translation services – CITS. Pjesëmarrja qytetare praktikant më të mira në ballkanin perëndimor dhe bashkimin europian, KCSF, Tetor 2011.
- <http://passthrough.fwnotify.net/download/320131/http://www.seas.columbia.edu/earth/wtert/sofos/SofiaConferenceWTERT.pdf>.
- Instituti Për Kërkime Dhe Alternativa Zhvillimi – IDRA, LëvizAlbania. (2017). Udhërrëfyes për përfshirjen e Qytetarëve / Komuniteteve në Qeverisjen Vendore.

Jens Reinke, s. i. (2017, Mars 6). Intervistë në media Top Channel.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Lazarus, R.S. (1966). Psychological stress and the coping process. New York, NY, US: McGraw-Hill.

Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”.

Mark Hamer, Yoichi Chida. (2008, January). Active commuting and cardiovascular risk: A meta-analytic review. Preventive Medicine, Vol. 46, Issue 1 , pp. Pages 9-13.

Metodologjia për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat, industriale, urbane dhe rurale . (2018, Janar). Fletore zyrtare numur 4, VKM nr. 27, 17.01.2018 .

Miller, G. E., Cohen, S., & Ritchey, A. K. (2002). Chronic psychological stress and the regulation of pro-inflammatory cytokines: A glucocorticoid-resistance model. Health Psychology, 21(6), 531-541.

Ministria e Zhvillimit Urban, UNDP. Vlerësim i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në bashkitë Lushnjë, Divjakë, Fier, Berat, Kucovë, Vlorë, Gjirokastër dhe Delvinë me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre. (2017, Mars).

MsEwen, B. S. (1998). Protective and Damaging Effects of Stress Mediators. The New England Journal of Medicine , pp. 171-179.

Neubacher, F. M.Sc. Chemical Engineering (Austria), M.Sc. Technology & Policy (USA), Public acceptance and economic feasibility of Waste-to-Energy –Examples for Best Practice, WTERT WORK SHOP SOFIA 2014.

Segerstrom, S. C., & Miller, G. E. (2004). Psychological Stress and the Human Immune System: A Meta-Analytic Study of 30 Years of Inquiry. Psychological Bulletin, 130(4), 601-630.

SHTOJCA 1

PYETËSOR TIP MBI MATJEN E PERCEPTIMIT TË TRANSPARENCËS NDAJ PUSHTETIT VENDOR NË LIDHJE ME KONTRATAT KONCESIONARE PËR BASHKINË E FIERIT DHE DIVJAKËS

ANKETIM INDIVIDUAL

KonceSCAN është projekti i organizatës Opendoors_Albania nën mbështetjen e LëvizAlbania_DemokraciaVendore. Objektivat e tij janë matja e perceptimit qytetar ndaj shërbimeve publike të ofruara nga zbatimi i kontratave koncesionare / PPP nga pushteti vendor në Fier dhe Divjakë si dhe advokim në përkrahje të interesave të komunitetit lokal të afektuar. Nisur nga ky objektivi anketimi do të fokusohet në: 1. Vlerësim mbi informimin dhe ndërgjegjësimin publik për shërbimet e ofruara nga zbatimi i kontratave koncesionare; 2. Matja e perceptimit të transparencës ndaj Pushtetit Vendor në lidhje me realizimin dhe vënien në zbatim të këtyre kontratave; 3. Hulumtim i impaktit të tyre ligjor, mjedisor, social dhe ekonomik tek individët e afektuar. Anketimi i mëposhtëm përbëhet nga pyetje që i refrohen sejcilës prej dimensioneve të sipërpërmendura.

Informacionet e mbledhura do mbeten konfidenciale dhe të gjitha të dhënat do të analizohen të grupuara pa asnjë referim ndaj individëve, institucioneve dhe organizatave të veçanta.

Ju lutem dergoni formularin e plotësuar ne adresën e email: opendoor_center@yahoo.com

TË DHËNA SOCIO-DEMOGAFIKE

Luteni t'i përgjigjeni çdo pyetje duke zgjedhur vetëm njërën nga alternativat e renditura. Atje ku shënohet specifikisht luteni të jepni një përshkrim të shkurtër

| | |
|-----------------------------|--|
| Kodi i të anketuarit | |
| Gjinia | <input type="checkbox"/> Femër |
| | <input type="checkbox"/> Mashkull |
| Vendlindja | <input type="checkbox"/> Fier |
| | <input type="checkbox"/> Diviakë |
| | <input type="checkbox"/> Tjetër (specifikisht) |
| Vendbanimi | <input type="checkbox"/> Fier |
| | <input type="checkbox"/> Diviakë |
| Grupmosha | <input type="checkbox"/> 18 |

| | |
|-------------------------------------|---|
| | <input type="checkbox"/> 19-25 |
| | <input type="checkbox"/> 26-35 |
| | <input type="checkbox"/> 36-45 |
| | <input type="checkbox"/> 46-55 |
| | <input type="checkbox"/> 56-65 |
| | <input type="checkbox"/> < 65 |
| Edukimi | <input type="checkbox"/> Nivel i ulët |
| | <input type="checkbox"/> Nivel i mesëm |
| | <input type="checkbox"/> Nivel universitat |
| | <input type="checkbox"/> Nivel post-universitar |
| Punësimi | <input type="checkbox"/> I pa punë |
| | <input type="checkbox"/> Student |
| | <input type="checkbox"/> Sipërmarrës (<i>specifiko</i>) |
| | <input type="checkbox"/> Këshill Bashkiak (<i>specifiko</i>) |
| | <input type="checkbox"/> OJF (<i>specifiko</i>) |
| | <input type="checkbox"/> I punësuar në sektorin privat |
| | <input type="checkbox"/> I punësuar në sektorin shtetëror |
| | <input type="checkbox"/> Media (<i>specifiko</i>) |
| | <input type="checkbox"/> Pension |
| | <input type="checkbox"/> Tjetër (<i>specifiko</i>) |
| Niveli i të ardhurave mujore | <input type="checkbox"/> > 30.000 lek |
| | <input type="checkbox"/> 30.000- 59.000 lek |
| | <input type="checkbox"/> 60.000- 79.000 lek |
| | <input type="checkbox"/> 80.000-99.000 lek |
| | <input type="checkbox"/> 100.000-150.000 lek |
| | <input type="checkbox"/> < 150.000 lek |

NDËRGJEGJËSIMI DHE NIVELI I INFORMIMIT MBI KONTRATAT KONCESIONARE

Lutemi t'i përgjigjeni çdo pyetje duke zgjedhur vetëm njëën nga alternativat e renditura.

Atje ku shënohet specifikisht, lutemi të jepni një përshkrim të shkurtër

| | Aspak | Pak | Disi | Mjaftueshëm | Shumë |
|--|-------|-----|------|-------------|-------|
| Sa të interesuar jeni për çeshtje që prekin komunitetin ku ju jetoni? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| Sa të informimuar jeni mbi kontratën koncensionare aktuale? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| A keni marrë informacion mbi kontratën para nënshkrimit të saj? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| A jeni në dijeni mbi ndryshime të mundshme të kontratës koncensionare? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| A janë këto ndryshime në të mirën e përbashkët të komunitetit? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| Sa ka reaguar media ndaj kësaj kontrate? <i>(specifikisht disa prej tyre)</i> | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Sa mendoni se ka ndikuar shoqëria civile ndaj kësaj kontrate? <i>(specifiko disa prej tyre)</i> | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| A ka individëve të caktuar të komunitetit që ju i njihni që kanë reaguar ndaj kësaj kontrate? <i>(specifiko ndonjë rast të veçantë)</i> | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| A kanë influencuar sipërmarrësit ndaj kësaj kontrate ? <i>(specifiko disa prej tyre)</i> | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

MATJA E PERCEPTIMIT TË TRANSPARENCËS NDAJ PUSHTETIT VENDOR

Luteni t'i përgjigjeni çdo pyetje duke zgjedhur vetëm njërën nga alternativat e renditura. Atje ku shënohet specifiko luteni të jepni një përshkrim të shkurtër

| | Aspak | Pak | Disi | Mjaftueshëm | Shumë |
|---|-------|-----|------|-------------|-------|
| Sa transparent kanë qenë institucionet në informacionet që kanë dhënë mbi koncensionet? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

| | | | | | |
|---|----------|----------|----------|----------|----------|
| A jeni të kënaqur me organizimin e dëgjësive publike për komunitetin? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| Sa të informuar jeni mbi anët positive/negative të kontratës në zhvillim? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| Sa është përcjellë informacioni mbi kontratën koncesionare në faqen zyrtare/ FB të institucionit përgjegjës? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| Sa është përcjellë informacioni mbi kontratën koncesionare nëpërmjet medias? (gazeta lokale, Tv lokale,etj) | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| Sa është shpërndarë gojarisht informacioni në komunitet mbi kontratën koncesionare? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

HULUMTIMI I IMPAKTIT LIGJOR, MJEDISOR, SOCIAL DHE EKONOMIK TEK INDIVIDËT E AFEKTUAR

Lutni t'i përgjigjeni çdo pyetje duke zgjedhur vetëm njërin nga alternativat e renditura. Atje ku shënohet specifikisht luteni të jepni një përshkrim të shkurtër

| IMPAKTI LIGJOR | | | | | |
|--|--------------|------------|-------------|--------------------|--------------|
| | Aspak | Pak | Disi | Mjaftueshëm | Shumë |
| A keni informacion se çfarë do të thotë kontratë koncesionare? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| A keni informacion mbi eksperiencën të suksesshme kontratash koncesionare brenda dhe jashtë vendit? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| A mendoni se janë respektuar ligjet në fuqi në lidhje me kontratën koncesionare? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| A mendoni se janë evituar abuzimet nga pushtetarë dhe përfaqësues të ndryshëm politik? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| Sa të kënaqshëm e gjykoni vendimin mbi vendit ku do të zbatohet kontrata koncesionare? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| | | | | | |

IMPAKTI MJEDISOR

| | Aspak | Pak | Disi | Mjaftueshëm | Shumë |
|--|--------------|------------|-------------|--------------------|--------------|
| A jeni të informuar për ndikime në mjedis (ajër, ujë, territor) nga zbatimi i kësaj kontrate? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| Sa mendoni se do të respektohen kriteret në grumbullimin e mbetjeve duke përdorur pajisjet, teknologjinë dhe distancën e duhur të vetëgrumbullimit? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| Sa mendoni se do të respektohen kriteret për mosndotjen e ajërit në zonat e zbatimit të kontratës koncesionare? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| Sa -mendoni se do të respektohen kriteret për mosndotjen e burimeve ujore dhe nëntokësore? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| Sa mendoni se do të respektohen kriteret për mirëmbajtjen e higjenës në zonën përreth? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

| IMPAKTI SOCIAL | | | | | |
|--|--------------|------------|-------------|--------------------|--------------|
| | Aspak | Pak | Disi | Mjaftueshëm | Shumë |
| A mendoni se zona përreth do të zhvillohet me aktivitetin e kontratës? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| Sa aktiv kanë qënë banorët e zonës në mbrojtje të interesave të tyre? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| Sa shqetësuese e konsideroni nivelin e zhurmave dhe të vibrimeve të bezdishme gjatë zhvillimit të aktiviteteve nga kontata? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| Sa mendoni se mund të rëndohet trafiku nga automjetet e rënda të ndërtimit me fillimin e zbatimit të kontratës? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| IMPAKTI EKONOMIK | | | | | |
| | Aspak | Pak | Disi | Mjaftueshëm | Shumë |
| A mendoni se do të rritet punësimi dhe kualifikimi i banorëve të zonës me kontratën koncesionare? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| A mendoni se kontrata do të ndikojë në shtimin e bizneseve të reja në zonat përreth? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| A mendoni se kontrata do të sjellë më shumë të ardhura për ekonominë lokale? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| A jeni të informuar mbi të ardhurat specifike që do të gjenerojë ky aktivitet? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| A mendoni se kjo kontratë është alternativa më e mirë e mundëshme në garantimin e përfitimeve për ekonominë lokale? | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

Ju faleminderit për pjesëmarrjen!

Rezultatet e anketimit do të gjenden të publikuara në Mini - studimin mbi dimensionet e impaktit social, ekonomik dhe mjedisor mbi dobishmërinë dhe efektivitetin e kontratave.

Ju lutem dergoni formularin e plotësuar ne adresen e email: opendoor_center@yahoo.com